



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:105685

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05619942

K.DH.SH.II.nr.325/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me seli ne Prishtinë, rr.”Armend Daci”nr.1, ndaj debitorit “Bajramaliu” shpk, me nr. Biznesi 70367060 me seli ne Hani Elezit, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sabri Kryeziu avokat nga Lipjani, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, te parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1607/22 dt.18.12.2023, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me seli ne Prishtinë rr.”Armend Daci” nr.1, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1607/22 dt.18.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1607/23 dt.18.12.2023, ne pjesën e parë te dispozitivit te këtij aktvendimi e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “Bajramaliu” shpk, me nr. Biznesi 70367060 me seli ne Hani Elezit, ndërsa urdhrin përmbartimor P.nr.272/22 dt.26.04.2022, i lejuar nga përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, e ka anuluar. Ne pjesën e dytë te dispozitivit ka detyruar kreditorin Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me seli ne Prishtinë, rr.”Armend Daci”nr.1 qe ne emër te shpenzimeve te procedurës përmbartimore, debitorit t’ia paguaj shumen e përgjithshme prej 1,396.50 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jot të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje si dhe të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lejohet urdhri përmbarimor.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), me seli në Prishtinë, rr."Armend Daci"nr.1, me datën 26.04.2022 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit "Bajramaliu" shpk, me nr. Biznesi 70367060 me seli në Hani Elezit, në bazë të dokumentit përmbarues-Aktvendimit nr.5480 dt.19.04.2020, i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, i ekzekutueshëm nga data 07.04.2022 dhe i formës së prerë nga data 22.03.2022. Përmbaruesi Privat Besnik H.Aliu, Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.272/2022 dt.26.04.2022, ka obliguar debitorin që kreditorit t'ia paguaj shumën e detyrimit në bazë të titullit përmbarimor për shkak të mos pagesës së rentës minerare si dhe interesin mujor prej 2% e po ashtu edhe shpenzimet e përmbarimit.

Ndaj Urdhrit Përmbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datë 29.04.2022, përmes së cilit deklaroi se me kreditorin në procedurë administrative janë pajtuar që debitori detyrimet të paguaj në këste, paraprakisht janë pajtuar që të paguhet shumën prej 30% e interesit si dhe 30% e detyrimit për rentën minerare të papaguar si kusht për arritjen e marrëveshjes për pagesa me këste, shton se me datën 31.03.2022 ka paguar shumën prej 12,158.04 euro, shumën prej 9,037.59 euro dhe po ashtu të njëjtën datë edhe shumën prej 4,952.25 euro dhe këstin në të njëjtën datë me shumën prej 5,942.70 euro, të gjitha këto në Raiffaisen Bank në llogari të kreditorit, propozon që gjykata të marrë parasysh faktin se me kreditorin kanë arritur marrëveshje dhe marrëveshja ka filluar të zbatohet atëherë në kuptim të nenit 71 par.1 pika 2 lidhur me pikën 8 dhe 9 të LPP urdhri përmbarimor të hudhet si i palejuar.

Përgjigje në prapësimin e debitorit, me datën 17.05.2022 ka ushtruar kreditori përmes së cilit deklaroi se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë sepse debitori me kreditorin kanë hyrë në marrëveshje të pjesshme vetëm për një shumë të caktuar të borxhit ndërsa për pjesën tjetër të mbetur të borxhit në shumën prej 107,430.02 euro përfshirë dhe interesin debitori nuk ka hyrë në marrëveshje në bazë të dëshmi të paraqitura. Konsideron se asnjë nga pretendimet e paraqitura nga debitori nuk plotësojnë kushtet nga neni 71 i LPP dhe si të tilla duhet të hedhen

poshtë, andaj propozon qe gjykata ta refuzoi prapësimin e debitori dhe urdhrin përmbarimor ta le ne fuqi ndërsa kërkon te obligohet debitorit ne shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalles se Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen ne prapësim te kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1607/22 dt.18.12.2023, me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të njëjtit. Gjykata ne arsyetim te vendimit te saj i referohet neni 21 te LPP dhe vlerëson se aktvendimi mbi bazën e te cilit është lejuar përmbami nuk mund te shërbej si dokument përmbarimor sepse nga vet deklarimet e palëve rezulton se palët ne procedurë administrative kanë arritur marrëveshje për pagesën me këste te detyrimit i cili buron nga aktvendimi si titull përmbarimor i përdorur ne këtë çështje, andaj rezulton se palët janë pajtuar qe te mos kërkohej përmbarimi sipas aktvendimit ne fjalë. Gjykata ne këtë rast vlerëson se prapësimi i debitorit gjënë mbështetje ne nenin 71 par.1 pika 1.3 e LPP ndërsa konsideron se dokumenti mbi te cilin mbështetet propozimi për përmbarim nuk mund te shërbej si dokument përmbarimor dhe si rrjedhojë e kësaj edhe urdhri përmbarimor nga ana e përmbaruesit privat duhet te anulohet. Gjykata analizon pretendimet e kreditorit se marrëveshja e lidhur mes palëve për përmbushjen detyrimit nuk është respektuar nga ana e debitorit pasi i njëjti i ka mbetur borxh shumën e papaguar nga kjo marrëveshje prej 13,757.85 euro, por gjeti se këto pretendime nuk mund te jenë objekt shqyrtimi ne këtë procedurë sepse procedura përmbarimore lejon vetëm shqyrtimin e elementeve formale te dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi. Gjykata ka vendosur për shpenzime konform nenit 463 dhe 453 te LPK, duke vendor kështu si ne dispozitiv te njëjtit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës se Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe 184 te LPK, për të cilat shkelje Gjykata e shkalles se dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së si dhe as ne konstatim te gabuar te gjendjes faktike nga neni 183 te LPK .

Në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës se dytë, gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm me rastin e vendosjes sepse edhe kjo gjykatë ne bazë te shkresave ne lëndë konstaton se palët para inicimit te procedurës përmbarimore gje gjësisht me datën 31.03.2022 janë dakorduar për pagesën me këste te detyrimeve te debitorit te cilat detyrime rrjedhin nga Aktvendimi nr.5480 dt.19.04.2020 mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi. Edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 71 par.1 nenpar.1.3 te LPP, andaj marrë për bazë faktin e dakordimit te palëve për pagesën e detyrimeve me këste nga ana e debitorit rezulton se ka pushuar kërkesa për ekzekutim me dhunë nga ana e kreditorit ndërsa dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi nuk mund te shërbej më si titull përmbarimor. Po ashtu kjo gjykatë pranon përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë e cila konform provave ne lëndë dhe ne pajtim me dispozitat ligjore nga neni 463 dhe 453 te LPK si dhe Rregullores për Tarifate e Avokateve dt.18.03.2017, me te drejtë vendos ne lidhje me shpenzimet procedurale si ne pjesën e dytë te dispozitivit te aktvendimit te saj, sepse debitori përmes parashtresës me

shkrim te datës 23.11.2023 ka precizuar dhe provuar shpenzimet procedurale te krijuara lidhur me çështjen konkrete.

Gjykata e shkalles se dytë analizoi edhe pretendimet e kreditorit se debitori iu ka shmangur detyrimeve te tij ne vazhdimësi dhe se aktvendimi për shpenzimet procedurale është ne kundërshtim me nenin 454 te LPK, kjo gjykatë i vlerësoi si te pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe ne këtë procedurë ashtu qe aktvendimin e shkalles se parë e vërtetoj, ndërsa për realizim te pretendimeve te tij kreditori udhëzohet ne procedura tjera siç është ajo konestimore.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.325/24 me datë 24.04.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi